



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2279/ 6 prot.

Datë 17.09.2025

V E N D I M
Nr.1264/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (degë e shoqërisë mëmë RSM COMPANY) SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-54295-07-10-2025, me objekt “Rikonstruksion i Ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, me fond limit: 19,119,053.24 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues:

Operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h me NIPT L04803001U dhe adresë: Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godine Nr. 11 - kateshe, Shkalla 2, Kati 7, Tirane

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga: “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët dhe nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.07.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-54295-07-10-2025, me objekt “Rikonstruksion i Ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, me fond limit: 19,119,053.24 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 28.07.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 08.01.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të

prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

-OE “CARA” shpk	12,503,608	lekë	skualifikuar
-OE “RSM COMPANY” shpk	12,767,719	lekë	skualifikuar
- OE “NIKA” shpk	12,810,146.25	lekë	skualifikuar
4. OE “2 N” L31615017L	12,900,000	lekë	skualifikuar
5. BOE “ALBSTRUKTUR” sh.p.k & “OUEN” sh.p.k	13,373,511.91	lekë	kualifikuar
6. OE “KOMBEAS” sh.p.k	13,410,099	lekë	kualifikuar
7. OE “O.B.KONSTRUKSION” shpk	13,750,000	lekë	skualifikuar
8. BOE “J O G I” shpk	13,995,156	lekë	skualifikuar
9. OE “EURONDERTIMI 2000” shpk	14,452,233.97	lekë	skualifikuar
10. OE “AVDULI” shpk	14,648,522.38	lekë	skualifikuar
11. OE “XHAŠT SHPK” shpk	14,946,510.25	lekë	kualifikuar
12. OE “LIQENI VII” shpk	15,892,396.70	lekë	skualifikuar

II.4.Operatori ekonomik “RSM Company” shpk rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyet se: *“1.Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve, ne Pjesen II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne Formularin e Permbledhes te Vetdeklarimit, per Seksionet si ne vijim:*

- *Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____*

- *Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____*

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Vendimin Nr.816/2025, date 27.06.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.”

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 18.08.2025 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 25.08.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5727 dhe me nr. 2279 prot., datë 25.08.2025 e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi konkretisht duke pretenduar:

“

- I. **Së pari**, e kundërshtojm arsyen e skualifikimit se: “*Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____.”, pasi referuar pikës 1, të nenit 82, të ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar ndër të tjera parashikohet se:

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, sic është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.”

Kërkesa e mësipërmë e parashikuar në formularin e përmbledhës të vetëdeklarimit, është një kërkesë e cila përbën një shkakë përjashtimi **për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, sipas pikës b, të nenit 78**, të ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet se një nga shkaqet e përjashtimit **nga APP është: “mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik”.**

Dhe në përmbushje të kriterit të mësipërm dorëzohet një vërtetim i lëshuar nga Agjencia e prokurimit publik, që shoqëria jonë nuk është e përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për më tepër ky kriter kërkohet të plotësohet edhe në një pikë tjetër të po kësaj deklarate: “**A: DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGIITHSHME TE KUALIFIKIMIT, ne Formularin e Permbledhes te Vetëdeklarimit, per Seksionet si ne vijimë:**

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Adresën e ueb-it: [<http://www.app.gov.al/>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Agjencia e Prokurimit Publik]

Lloji i dokumentit: [Lista e operatorëve të skualifikuar]

Rezulton se kjo pikë është plotësuar nga shoqëria jonë, pasi në momentin që autoriteti kontraktor, klikon në linkun e faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, rezulton që shoqëria jonë nuk është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik dhe nëpërmjet këtij linku, Autoriteti Kontraktor verifikon të dyja kriteret dhe për më tepër që në këtë kriter thuhet se: “**Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomik të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.**”, duke përfshirë edhe pikën për të cilën shoqëria jonë është skualifikuar.

Që do të thotë se kriteri është plotësuar nga ana e shoqërisë jonë.



Pasi në përmbushje edhe te nenit të nenit 82, te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar është dhënë informacioni, ku autoriteti kontraktor mund ta verifikoj këtë kriter.

Në pikën 3 të nenit 92 të ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: “Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”

- II. **Së dyti**, e kundërshtojmë arsyen e dytë të skualifikimit se: *“Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____.”*

Për sa i përket kërkesës së mësipërme paga e një punonjësi vërtetohet nga e kontrata e punës së lidhur midis një punëdhënësi dhe një punëmarrësi, nëpërmjet një vendimi të brendshëm të shoqërise për ndryshimin e saj në rast se ka ndodhur ky ndryshim si dhe nëpërmjet listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Që do të thotë se të gjitha këto janë të dhëna të cilat nuk janë të aksesueshme nga cdo subjekt, pasi përmbajnë të dhëna personale të punonjësve dhe kërkohet që të respektohet ligji nr.124, date 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe për aksesin e tyre nga persona të tretë duhet të egzistojë një interes i ligjshëm dhe për më tepër ky aksesim të kryhet vetëm nga persona të autorizuar ose me vetë pëlqimin e subjektit të të dhënave.

Prandaj mos plotësimi i këtij kriteri, duke mos dhënë sqarime të nevojshme nuk përbën arsye për skualifikim, pasi sic parashikohet edhe në pikën 1, të nenit 82, te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar ndër të tjera parashikohet se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, sic është adresa në internet e bazës të të dhënave, cdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.”

Dhënia e sqarimeve të nevojshme është e detyrueshme vetëm në rast se autoriteti kontraktor ka mundësi që ti verifikoj këto të dhëna në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, që janë të domosdoshme të publikohen.



Në këtë kuadër, vlen të theksohet se edhe vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), mbi të cilin është mbështetur autoriteti kontraktor, nuk ka fuqi normative dhe nuk mund të zëvendësojë zbatimin e drejtë të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 (i ndryshuar). Ky vendim ka trajtuar të njëjtat dy rubrika të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku KPP ka arsyetuar se operatori duhet të jepte ‘indicie’ ose të dhëna referuese paraprake.

Megjithatë, vetë arsyetimi i KPP-së pranon se plotësimi i kriterëve të përgjithshme në këtë fazë bëhet me deklarime paraprake dhe se dokumentet provuese dorëzohen vetëm nga operatori i renditur i pari pas shpalljes së renditjes, në përputhje me nenin 26 të VKM nr. 285/2021 (i ndryshuar). Ligji nuk parashikon detyrim për të dhënë indicie paraprake kur nuk ka një bazë shtetërore për verifikim; për këtë arsye, FPV-ja është konceptuar nga APP me shënimin “Sqarime, nëse është e nevojshme”, që lidhet me të dhënat e verifikueshme sipas nenit 82 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 (i ndryshuar).

Gjithashtu, pika 2 e të njëjtit nen parashikon shprehimisht se autoriteti kontraktor, kur e sheh të nevojshme **PËR GARANTIMIN KORREKT TË PROCEDURËS**, mund t’u kërkojë ofertuesve sqarime dhe dokumente mbështetëse. Në këtë kuadër, autoriteti kontraktor, si organ publik përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, mban përgjegjësinë parësore dhe ka interesin më të lartë për respektimin e plotë të procedurave ligjore dhe garantimin e përdorimit me transparencë të buxhetit të shtetit. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor kishte detyrimin të ushtronte këtë kompetencë dhe të kërkonte sqarime nga operatori ekonomik për këto rubrika, si mënyra e vetme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës dhe mbrojtjen e interesit publik.

Edhe sikur autoriteti kontraktor të kishte menduar se këto pika lidhen me të dhëna të verifikueshme në bazë shtetërore, mungesa e plotësimit paraprak duhej trajtuar si devijim formal dhe jo si mangësi thelbësore.

Sipas vetë logjikës së KPP-së, kriteret e përgjithshme kanë synim t’i shërbejnë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, përmes dokumentacionit që provon zotërimin e kualifikimeve teknike, profesionale, kapaciteteve ekonomike e financiare, mjeteve, pajisjeve, reputacionit, përvojës dhe personelit për realizimin me sukses të kontratës. Mungesa e një indicieje në këto dy rubrika nuk prek këtë synim dhe, në respektim të nenit 82 pika 2 dhe nenit 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 (i ndryshuar), autoriteti kontraktor duhej të kërkonte sqarime dhe jo të kalonte menjëherë në skualifikim. Interpretimi që mungesa e indicieve sjell pavlefshmëri automatike është formalist dhe i pabazuar në ligj.

Në vazhdim të këtij arsyetimi, duhet theksuar se kjo procedurë prokurimi bazohet në kriterin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, pra mbi çmimin më të ulët. Pas skualifikimit të padrejtë të ofertës sonë, autoriteti kontraktor rrezikon të lidhë kontratën me një ofertues më të shtrenjtë, duke shkaktuar kosto të panevojshme dhe dëm të drejtpërdrejtë për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së interesit publik.”

Për të gjitha arsyet e parashtruara më sipër, kërkojmë shfuqizimin e vendimit të skualifikimit dhe kualifikimin e ofertës sonë si të vlefshme, në mënyrë që të vijojë

procedura e prokurimit në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe në respektim të parimeve të konkurrencës së ndershme, barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, transparencës dhe proporcionalitetit, duke garantuar mbrojtjen e interesit publik dhe përdorimin efikas të fondeve publike.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2279/1 prot., datë 26.08.2025.

II.8. Autoriteti kontraktor me shkresën 2158/6 prot., datë 01.09.2025, protokolluar me tonën me nr.2279/2 prot., datë 02.09.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) me nr.86/2025, datë 01.09.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h.

II.9. Referuar vendimit të KSHA nr.86/2025, datë 01.09.2025, rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar:

II

Komisioni i shqyrtimit të ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “R|S|M CONSTRUCTION” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, me arsyen se nuk ka plotësuar saktë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, KSHA arsyeton se:

Në nenin 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të genieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja 38 detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributeve të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e 39 prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “I. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet

operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në pikën 1 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Referuar bazës ligjore të lartëpërmendur, si edhe legjislacionit në fuqi në tërësi për prokurimin publik, “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, përbën një provë paraprake në vend të disa vërtetimeve/dokumenteve të lëshuara nga ente të caktuara publike ose palë të tjera të treta dhe në këtë kuptim çdo deklaram i bërë përfshirë edhe dhënien e informacioneve të nevojshme ndihmëse për verifikimin e këtyre deklarimeve është barrë dhe përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të operatorit ekonomik ankimes, KSHA konstaton se operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” shpk nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referuese për plotësimin e të gjitha rubrikave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht për rubrikën “*Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate*” dhe rubrikën “*Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë*” nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi.

KSHA gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme.

Referuar sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave të cituara më sipër në këtë vendim siç ky formular parashikon. KSHA gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues "R|S|M CONSTRUCTION" shpk ka plotësuar disa prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ndërsa për dy rubrika të cituara më lart, lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim, nuk ka dhënë informacionin që ky formular kërkon, duke mosplotësuar kështu pikën 2.1.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Për më tepër, KSHA thekson se KVO në mbështetje të skualifikimit është referuar dhe në vendimmarrjen e KPP, konkretisht në vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025. Gjithashtu, në mbështetje të arsyeve të skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik ankimues, KSHA thekson se me të njëjtin arsyetim, KPP në vendimin Nr. 209/2025, datë 07.02.2025 ka gjykuar të drejtë skualifikimin për mosplotësimin e 2 rubrikave të sipërcituara të operatorit ekonomik në procedurën përkatëse, konkretisht me arsyetimin se:

"Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referuese për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Konkretisht për rubrikat: Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate; Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 10, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave të cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e

dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues "4 S" SHPK ka plotësuar disa prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ndërsa për dy rubrika të cituara më lart, lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim, nuk ka dhënë informacionin që ky formular kërkon, duke mosplotësuar kështu pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "R|S|M CONSTRUCTION" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.10. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h KPP gjen me vend të sqarojë pozitën juridike dhe legjitimitetin e ankimuesit pas evidentimit se në sistemin e ankesave elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik rezulton se për procedurën e prokurimit të sipërcituar ka aplikuar operatori ekonomik “RSM Company” SHPK. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Për degët ose zyrat e shoqërive të huaja” për subjektin “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h me NIPT L04803001U dhe përfaqësues të degës znj. E. K forma ligjore e saj rezulton “*Degë e shoqërisë së huaj*” dhe në pikën 13 “*Të dhënat e shoqërisë së huaj*” rezulton “14.emri i shoqërisë: RSM Company. Gjithashtu bazuar në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës subjekti “RSM Company” SH.P.K i cili ka aplikuar në APP për këtë procedure prokurimi ka numer unik identifikimi 810802422. Në nenin 3 pika 3 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar parashikohet se: “3. *Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.*” Po aty në nenin 9 pika 1 dhe 2 parashikohet se: “1. *Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.* 2. *Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.*” Referuar nenit 9 pika 2 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar degët sikurse është rasti konkret “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë (në këtë rast me RSM Company) dhe personaliteti juridik në vetvete lidhet me mudësinë e personit juridik për të fituar të drejta por edhe për të përmbushur detyrime dhe në këtë kuptim ushtrimi i të drejtave nga shoqëria për degën, si në rastin konkret aplikimi në APP nga shoqëria RSM Company për këtë procedurë prokurimi do të konsiderohet sikur është kryer nga vetë dega. Akoma më tej KPP vëren se aplikimi në sistemin e prokurimeve elektronike të APP-së nga shoqëria RSM Company është kryer me numër identifikimi të subjektit 810802422 i cili bazuar në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës përputhet me numrin e identifikimit të subjekti RSM Company cfare tregon se aplikimi në sistemin e APP-së është kryer nga shoqëria e huaj për degën e saj në Shqipëri “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h dhe në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara për shkak se shoqëria dhe dega gëzojnë të njëjtin personalitet juridik ky veprim i kryer nga shoqëria RSM Company është një veprim ligjor dhe për këtë shkak operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h legjitimohet për të praqitur ankesë për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, për skualifikimin me arsyet se : “1.Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e të ciles/cilit autoriteti mund të beje verifikimin e vetdeklarimeve, ne Pjesen II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË

PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne Formularin e Permbledhes te Vetdeklarimit, per Seksionet si ne vijim:

• *Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____*

• *Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____*

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Vendimin Nr.816/2025, date 27.06.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, të shtojcës 7, “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*

Ndërsa në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, Pjesa II. “Shkaqet e Përjashtimit” pika A. “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____ {
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, për operatorin ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h është dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku konkretisht për pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” ka deklaruar si më poshtë:

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Adresën e ueb-it: [https://qkb.gov.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Qendra Kombetare e Biznesit] Lloji i dokumentacit: [Ekstrakt i thjeshtë/ Ekstrakt Historik]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <u>Ky dokument nuk është i disponueshem ne forme elektronike por terhiqet prane Gjykeses, vertetim nga Gjykata qe shoqeria nuk ka ceshtje te hapura ne ngarkim te saj apo qe ka qene e denuar per vepra te natvres qe parashikohen ne nenin 76/1 te LPP</u>
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:
1. <u>Znj.E K</u> atesia <u>datelindja</u>, vendlindja <u>me nr</u>, ne cilesine e <u>administratores te “R S M CONSTRUCTION”</u> dege e shoqerise se huaj “RSM COMPANY” sh.p.k. 2. <u>Z.A K</u> atesia <u>datelindja</u>, vendlindja <u>me nr ID</u> ne cilesine e <u>ortakut “R S M CONSTRUCTION”</u> dege e shoqerise se huaj “RSM COMPANY” sh.p.k. etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Adresën e ueb-it: [https://e-albania.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve]

Lloji i dokumentit: [Deshmi Penaliteti]
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <u>Ky dokument nuk është i disponueshem ne forme elektronike por terhiqet prane Gjykates, vertetim nga Gjykata qe shoqeria nuk eshte denuar .</u>
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Adresën e ueb-it: [https://e-albania.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane] Lloji i dokumentit: [Vertetim Statusi Aktiv]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Adresën e ueb-it: [https://e-albania.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane] Lloji i dokumentit: [Vertetim]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Adresën e ueb-it: [https://e-albania.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Furnizuesi i Sherbimit Universal OSHEE Group] Lloji i dokumentit: [Vertetim Debie]
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Adresën e ueb-it: [https://qkb.gov.al] Autoritetin ose organin lëshues: [Qendra Kombetare e Biznesit] Lloji i dokumentit: [Ekstrakt i thjeshte/ Ekstrakt Historik]

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Adresën e ueb-it: [<http://www.app.gov.al/>]

Autoritetin ose organin lëshues: [Agjensia e Prokurimit Publik]

Lloji i dokumentit: [Lista e operatoreve te skualifikuar]

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Ky dokument nuk është i disponueshem ne forme elektronike por terhiqet prane Institucioneve perkatese qe kane te bejne me leje te ndrvshme mjedisore, certifikata kualifikimesh punonjesish si dhe vertetim gjykate qe verteton se shogeria nuk eshte denuar per shkelje te ligjit.

III.1.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka

fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. *Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim..*

III.1.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë,*

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga

i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.8. Nisur nga arsyet e skualifikimit dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton, se për operatorin ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h është ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, shtojca 8, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në këtë formular, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.2 të këtij vendimi, bazuar në arsyet e skualifikimit vërehet se operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h për pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, për dy prej rubrikave të cilat kanë shërbyer edhe si arsye skualifikimi konkretisht “Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. **si dhe** “Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.” nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues në rubrikat përkatëse, duke mos dhënë asnjë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika por në ndryshim nga plotësimi i rubrikave të tjera, ato janë lënë të pa plotësuar. KPP gjykon se në këtë fazë plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit kryhet përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe vetëm para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit operatori ekonomik i kualifikuar i pari paraqet në autoritet kontraktor dokumentet provuese të deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentat e tjera të dorëzuara në rrugë elektronike sipas parashikimeve të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Komisioni i

Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë, e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 8, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për dy prej rubrikave në pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht për: *“Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.” si dhe “Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.”* KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, KPP gjykon se operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h nuk ka plotësuar të gjitha rubrikat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, pra nuk ka dhënë informacionin që ky formular kërkon për dy prej rubrikave të cituara më sipër duke mosplotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-54295-07-10-2025, me objekt “Rikonstruksion i Ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, me fond limit: 19,119,053.24 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

